VENDIM
Nr.828, datë 29.7.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE "MASTER I NIVELIT TË DYTË" NË FAKULTETIN E INXHINIERISË ELEKTRIKE TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve, të ciklit të tretë, "Master i nivelit të dytë", në "Automatikë dhe teknologjitë e kontrollit", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të dytë" (MND), në automatikë dhe teknologjitë e kontrollit.

2. Programi i studimeve "Master i nivelit të dytë" realizohet me jo më pak se 60 kredite dhe kohëzgjatja normale është, minimumi, një vit.

3. Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha